

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Abdixhiku vlerëson tërheqjen e Sejdiut: Dëshmoi dinjitet përballë histerisë politike
ADRESA	https://albeu.com/kosove/abdixhiku-vlereson-terheqjen-e-sejdiut-deshmoi-dinjitet-perball-e-histerise-politike/1011396/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:35:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:30:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ae6654d109c92e685ef62afd4bd24b0e5b9b6b7f68ed0b2299e78ab336869b04
TEKSTI	cccc3db009cd7c8d3f38e6b55a5064692a908e85f13265be17547e286294527
PAMJA	332947c42d2ff8f0505dae45ae0423bf0e87458ff9925a45dc75757661329e07

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f531e7e58ab639d80783b80a43d21ca18ce1079108dbb7051ae42a497efe55ff
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f531e7e58ab639d80783b80a43d21ca18ce1079108dbb7051ae42a497efe55ff>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Abdixhiku vlerëson tërheqjen e Sejdiut: Dëshmoi dinjitet përballë histerisë politike



Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas vendimit të Bekim Sejdiut për të hequr dorë nga kandidatura për president të Kosovës.

Abdixhiku e ka çmuar qëndrimin e Sejdiut gjatë këtij procesi, duke thënë se tërheqja e tij përballë asaj që e cilësoi si "histeri politike" tregon se ai do të ishte një kandidat i përshtatshëm për postin e presidentit.

"Bekim Sejdiu tregoi dinjitet. Tërheqja e tij, përballë histerisë politike, dëshmon pikërisht pse një njeri me karakterin e tillë, do të ishte zgjedhja e duhur për President", ka shkruar Abdixhiku.

Kreu i LDK-së ka shprehur keqardhje për faktin që Kosova vazhdon të jetë pa president. Sipas tij, mungesa e një marrëveshjeje politike e ka lënë vendin në kaos, bllokadë institucionale dhe drejt zgjedhjeve të reja.

"Keqardhje që sot nuk kemi President. Që në vend të një zgjidhjeje kemi kaosin politik, bllokadën si mjet dhe zgjedhjet e reja, edhe një herë, si qëllim", ka deklaruar ai.

Abdixhiku ka kritikuar edhe sulmet e drejtuara ndaj Sejdiut, duke vlerësuar se ai u vu në shënjestër në mënyrë të padrejtë dhe se përpjekjet për ta dëmtuar figurën e tij nuk kishin të bënin realisht me të.

"Keqardhje edhe për Bekimin, që padrejtësisht u bë shënjestër e sulmeve të paprecedenta për mbytjen e karakterit të tij. Përbaltja e tij kishte të bënte më së paku me të", ka shkruar lideri i LDK-së.

Sipas tij, urrejtja dhe inati personal janë shndërruar në mjete më të fuqishme se përgjegjësia ndaj vendit. Abdixhiku ka theksuar se në politikën e sotme duket më e rëndësishme t'i shkaktohet dëm kundërshtarit sesa të mbrohet interesi institucional.

"Urrejtja si mjet dhe inati personal si karakteristikë e pashpjegueshme e politikanëve të sotëm, janë bërë më të forta se përnigënia ndaj vendit. E rëndësishme t'i bëjmë dëm tjetrit" ka deklaruar ai.

të fundit /



Mundësia nis përgatitjet për zgjedhjet vendore të 2027-ës, Shehaj: ...



Prokuroria kërkon paraburgim për 40-vjeçarin nga Kratova,...



Karburantet shtrenjtohen sërish, Shqipëria pa masa të...



The Guardian": Azilkërkuesit e kthyer nga Britania në Franc...



Chelsea rikthehet për Fermín López dhe përgatit një ofertë mb...



Hafir Hoxha kërkon sqarime për thirrjen e Lushtakut: Çfarë...



Lamine Yamal intensifikon kandidaturën për Topi...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ai ka shprehur gjithashtu shqetësimin se Kosova po i largon njerëzit e mirë, duke nënvizuar se vendi ka nevojë për ta, por shpesh i refuzon lehtësisht.

Situatën aktuale politike në Kosovë, Abdixhiku e ka cilësuar si "PISA politike", duke kritikuar bllokimet, ngecjen, sulmet personale dhe mundësinë që vendi të përfundojë sërish në zgjedhje, edhe pas proceseve të ardhshme zgjedhore.

"Kjo është PISA politike e Kosovës. Me rëndësi t'i rrënojmë çdo përpjekje normale sot! Bllokohemi, ngecim, urrejmë, mbysim karaktere dhe përfundojmë sërish në zgjedhje. Edhe pas tyre, në të tjerat", ka shkruar Abdixhiku.

Në përmbyllje të reagimit, kryetari i LDK-së e ka falënderuar Sejdiun për gatishmërinë dhe dinjitetin e treguar vazhdimisht, duke i cilësuar këto virtyte si vlerë në klimën e sotme politike.

"Të faleminderit Bekim për gatishmërinë dhe dinjitetin e treguar në vazhdimësi. Në kohë të politikës së sotme, këto virtyte janë vlerë", përfundon reagimi i Abdixhikut.

Shtuar më 14.09.2026 19:30

Tags: Kryetari i LDK-së , Sejdiu , Tërheqja



Hafir Hoxha kërkon sqarime për thirrjen e Lushtakut: Çfarë armësh ...



Bekim Sejdiu heq dorë nga gara për President të Kosovës



Hamza diskuton me ambasadorin e BE-së, Dirk Schuebel, integrimin...



Gola: Pretendimet për tensione ndëretnike në Kosovë duhen dëshmuar...



Mbrojtjet në Hagë: Aktakuza ndaj Fazliut lidhet me dy takime, ndërsa ajo...



Policia e Kosovës dhe SHBA-ja zgjerojnë partneritetin kundër krimit...



Kriza institucionale në Kosovë/ BE: Gjykata Kushtetuese duhet të...



Platforma "Liria ka emër" paralajmëron aktivitete në Hagë: 16 shtatori pritet të...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Vellaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.